



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtori për Administratë të përgjithshme
Odejonje za Opštu upravu

III Nr. lprot. 1263 Më 05.04.2024
Bil. prot. Dt. 05.04.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT TREMUJOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

JANAR - MARS 2024

KOMUNA E RAHOVECIT

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	2
AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE.....	2
STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE	4
PËRFUNDIM.....	5

HYRJE

Raporti të cilin po e prezantojmë, pasqyron punën e Drejtorisë për Punë Inspektuese, për periudhën: janar – mars të vitit 2024. Në këtë raport janë të përfshira punët dhe aktivitetet e kryera dhe të ndërmarra nga Drejtoria për Punë Inspektuese të cilat janë paraqitur sipas sektorëve të cilët i mbulojmë si dikaster. Inspektimet kanë për qëllim: Zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të subjekteve të inspektimit.

AKTIVITETET E INSPEKTIMEVE NË PËRMBUSHJEN E OBJEKTIVAVE

Gjatë periudhës janar – mars, në Drejtorinë për Punë Inspektuese, inspektimet janë realizuar në tërësi duke e mbuluar territorin e Komunës së Rahovecit, - DPI është organizuar në grupe inspektuese me nga 4 grupe të kombinuara sipas nevojës. Inspektimi në terren rregullisht fillon nga ora: 9:00: - 14:00, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë;

- Në total, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar afro 270 kontrolle inspektuese. Krahas prioriteteve siç janë: Parandalimi i ndërtimeve pa leje, Lirimi i Hapësirave Publike, Mbrojtja e Mjedisit, Luftimi i Ekonomisë së Zezë, Mbrojtja e Konsumatorit, prioritet dhe fokus i yni kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve;
- 51 shfrytëzuesve të hapësirave publike, para lokaleve afariste u janë shpërndarë urdhëresa për tu pajisur me lejet përktëse për shfrytëzim të hapësirave publike, përkitazi me rregulloren komunale;
- Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, 28 është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë;
- 28 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës, për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike;
- Janë inspektuar 38 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore me afat të skaduar, vendosjen e çmimeve në produkte etj;
- Është bërë verifikimi periodik i peshoreve në furrat e bukës;
- Në fushën e ndërtimit për këtë periudhë raportuese, sipas raportit të punës nga inspektori përkatës, janë inspektuar 36 objekte ndërtimore të kategorisë së parë, poashtu është bërë inspektimi i dokumentacionit teknik (projekti i ndërtimit, lejet e ndërtimit, janë shqiptuar 21 gjoba mandatore për ndërtim pa leje, si dhe janë

obliguar që të pajisen me leje ndërtimore, 23 prej tyre kanë paraqitur kërkesë për leje, 15 janë pajisur me leje dhe 8 janë në proces;

- Poashtu, në sektorin e ndërtimit është bërë përpilimi i procesverbaleve për gjendjen e punimeve në vend ndërtim, për respektimin ose mosrespektimin e kushteve të përcaktuara për ndërtim, dhënia e vendimit për ndërprerjen e punimeve ndërtimore deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedurale si dhe janë marrë vendime për ndërprerjen (pezullimin) e punimeve, deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedurale;
- Janë inspektuar edhe disa prej subjekteve afariste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Rahovecit, ku prej tyre është kërkuar pajisja me Leje Mjedisore, 15 prej tyre janë pajisur me leje mjedisore pas urdhëresave nga inspektori i mjedisit;
- Në fushën e transportit publik ne në vazhdimësi kemi përcjellur nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve, se a janë duke i mbuluar mjaftueshëm dhe sigurtë linjat e transportit të udhëtarëve, në rendet e udhëtimit të cilat janë lëshuar nga organi kompetent komunal. Poashtu, janë kryer inspektime rutinore ku edhe janë urdhëruar autotaksi të bëjnë vazhdimin e lejes për kryerjen e transportit jo të rregullt të udhëtarëve.
- Janë trajtuar kërkesa të qytetarëve, kryesisht me problematika në sektorin e çështjeve komunale;

STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	21	8300 €
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUANLE	5	1000€
GJOBA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS	8	400 €
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	18	1250 €
<u>TOTALI:</u>	52	10,950.00€

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERA NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	8	80 €
PËLQIME PUNE	28	420 €
<u>TOTALI:</u>	44	500 €

<u>TOTALI I TË HYRAVE NË DPI :</u>	<u>JANAR – MARS 2024</u>	<u>11,450.00€</u>
---	---------------------------------	--------------------------

PËRFUNDIM

Përkundër të gjitha sfidave, konsiderojmë që jemi në rrugë të mirë për përmbushjen e të gjitha objektivave, sigurisht edhe me një bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera të cilat po na ndihmojnë me arritjen e rezultateve konkrete.

Nora BOSHNIJAKU

Drejtoreshë për Punë Inspektuese

